



RAPORT VJETOR

2008

1. Të përgjithshme

- 1.1 Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) dhe qëllimi i saj.
- 1.2 Organizimi dhe drejtimi.
- 1.3 Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave.

2. Drejtimit kryesore të veprimtarisë së ASD-së

- 2.1 Kontributi fillestar.
- 2.2 Primi vjetor i sigurimit dhe politikat e tij.
- 2.3 Kompensimi.
- 2.4 Administrimi i Mjeteve Financiare.

3. Gjendja e depozitave të siguruara dhe struktura e tyre

- 3.1 Ecuria e depozitave të siguruara
- 3.2 Struktura dhe numri i depozituesve sipas niveleve të përcaktuara në ligj

4. Gjendja financiare e ASD-së

- 4.1 Struktura e bilancit dhe ecuria e tij.
- 4.2 Kapitali dhe ecuria e tij.
- 4.3 Fitimi dhe ecuria e tij.
- 4.4 Kontrolli i librave dhe i llogarive të ASD.
- 4.5 Raporti i Auditit të Brendshëm.

5. Një vështrim mbi veprimtaritë e tjera të ASD-së gjatë vitit 2008

- 5.1 Bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë, institucionet ndërkombëtare dhe homologët.
- 5.2 Edukimi dhe informimi i publikut.

6. Drejtimit kryesore të planit të zhvillimit për vitin 2009

Shkurtime

ASD	Agjencia e Sigurimit të Depozitave
IADI	International Association of Deposit Insurers
EFDI	European Forum of Deposit Insurers
FDIC	Federal Deposit Insurance Corporation
SHKK	Shoqëritë e Kursim Kreditit
FSVC	Financial Service Volunteer Corpus
FSAP	Financial Sector Assessment Program
BR	Banka Raiffeisen
BA	Banka Alpha
BISP	Intesa Sanpaolo Bank Albania
BKG	Banka Kombëtare e Greqisë
BBSH	Banka e Bashkuar e Shqipërisë
BPI	Banka e Parë e Investimeve
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BNT	Banka Ndërkombëtare Tregtare
BE	Banka Emporiki
BPC	Banka ProCredit
BIS	Banka Italiane e Zhvillimit
BT	Banka Tirana
BKSH	Banka e Kreditit të Shqipërisë
BP	Banka Popullore
UB	Union Bank

1. Të përgjithshme

1.1 Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe qëllimi i krijimit të saj

Agjencia e Sigurimit të Depozitave është institucion i krijuar në bazë të ligjit nr.8873, datë 29.03.2002, “Për Sigurimin e Depozitave”.

Qëllimi i krijimit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është sigurimi dhe kompensimi i depozitave të qytetarëve të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë, si anëtare të skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri, në bazë të kritereve dhe niveleve të përcaktuara në këtë ligj.

Në përmbushje të detyrimeve të saj ligjore, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, plotëson misionin kryesor të saj, atë të ndikimit në rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit bankar, forcimin e besimit të publikut nëpërmjet shmangies së riskut të humbjes së kursimeve të tyre gjatë një falimentimi të mundshëm të ndonjë banke, duke kontribuar kështu në ruajtjen e mirëqenies ekonomike të vendit.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave bën pjesë në institucionet që krijojnë dhe kontribuojnë në sigurinë financiare të sistemit, së bashku me Autoritetin Mbikëqyrës (Banka e Shqipërisë) dhe Ministrinë e Financave që është në funksionin e burimit të fundit financiar (*huadhenes i burimit te fundit*).

1.4 Organizimi dhe drejtimi i Agjencisë

Bazuar në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, Agjencia organizohet dhe administrohet nga Këshilli Drejtues dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga Banka e Shqipërisë me propozimin si më poshtë:

Dy anëtarë nga Banka e Shqipërisë;

Dy anëtarë nga Ministria e Financave;

Një anëtar nga Bashkimi Profesional i Ekspertëve Kontabël;

Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson autoritetin ekzekutiv të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

1.5 Anëtarësimi në skemën e sigurimit

Anëtarësimi në skemën e sigurimit të depozitave është i detyrueshëm për të gjitha bankat që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas nenit 3 të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për Sigurimin e Depozitave”, asnjë bankë nuk pranon dhe nuk grumbullon depozita kur nuk është e siguruar nga Agjencia.

Numri i bankave të siguruara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave në fund të vitit 2008 ka qenë 16, të cilat janë banka private shqiptare apo të huaja si më poshtë:

1. Banka Raiffeisen
2. Banka e Bashkuar e Shqipërisë
3. Banka Italiane e Zhvillimit
4. Banka Kombëtare Tregëtare
5. Banka Tirana
6. Dega e Bankës Kombëtare Greke Tiranë

7. Banka Ndërkombëtare Tregtare
8. Dega në Tiranë e Bankes Alpha
9. Intesa Sanpaolo Bank Albania
10. Banka ProCredit
11. Banka e Parë e Investimeve
12. Banka Emporiki, Shqipëri
13. Banka e Kreditit e Shqipërisë
14. Banka CREDINS
15. Banka Popullore/ Societé Générale Bank
16. Union Bank

Me bashkimin me përthithje të Bankës Italo Shqiptare nga Banka Amerikane e Shqipërisë, i cili u bë efektiv më 1 Janar 2008, numri i bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, ulet në **16**. Gjithashtu, me iniciativën e grupit Intesa Sanpaolo, Banka Amerikane e Shqipërisë në muajin Tetor 2008 ndryshoi emrin në Intesa Sanpaolo Bank Albania. Agjencia pajisi me çertifikatën e re të sigurimit të depozitave me emrin e ri të ndryshuar Intesa Sanpaolo Bank Albania.

2. Drejtimet kryesore të veprimtarisë së ASD

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, aktiviteti i së cilës rregullohet në Shqipëri nëpërmjet ligjit nr.8873 datë 29.03.2002 “Për Sigurimin e Depozitave”, siguron depozitat e individëve në sistemin bankar, kujdeset për përfshirjen në kohë të depozituesve në skemën e sigurimit të depozitave dhe kompenson depozitat në bankat të cilave ju hiqet (revokohet) licenca nga Autoriteti Mbikqyrës (Banka e Shqipërisë) sipas kriterëve të përcaktuara në ligj.

Aktiviteti i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave përfshin përcaktimin e primit vjetor të sigurimit për bankat e nivelit të dytë, mbledhjen e kontributit fillestar dhe primit vjetor të sigurimit, verifikimin e saktësisë së përlllogaritjes së këtij primi, investimin e mjeteve financiare si dhe funksionin final kryesor për realizimin e detyrimit të pagesës së kompensimit të depozituesve në bankat e nivelit të dytë që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në përputhje dhe me direktivën 94/19 të Komunitetit Europian për sigurimin e depozitave, Agjencia siguron të gjitha depozitat e individëve në lekë dhe monedhë të huaj, të konvertuara sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e ndërhyrjes. Agjencia siguron depozitat e individëve deri në 700 mijë lekë, me afat në lekë, depozitat me afat në valutë, depozitat pa afat në lekë, depozitat pa afat në valutë, çertifikatat e depozitave në lekë, çertifikatat e depozitave në valutë etj.

2.1 Kontributi fillestar

Gjithë institucionet që ushtrojnë veprimtari bankare në Shqipëri, detyrimisht janë anëtarë të skemës së sigurimit të depozitave. Bazuar në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, nenin 23 të tij, çdo bankë e siguruar duhet të paguajë në Agjenci një kontribut fillestar të barabartë me 0.5 për qind të kapitalit të nënshkruar të bankës. Gjatë vitit 2008 skemës së sigurimit të depozitave në Shqipëri nuk iu shtua asnjë subjekt i ri. Norma e përlllogaritjes së kontributit mbeti e njëjtë.

2.2 Primi i sigurimit dhe politikat e tij

Sipas nenit 24 të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, për çdo bankë të siguruar, primi vjetor i sigurimit të depozitës është 0.5 përqind e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, të regjistruara në fund të çdo dite pune për tre muajt e fundit të vitit të kaluar. Këtë prim të pagueshëm nga bankat e siguruara, Agjencia mund ta ulë deri në 0.1 për qind, vetëm në rast se mjetet financiare të saj, do të jenë jo më pak se 5 përqind të mesatares së këtyre depozitave, veprim i cili kryhet me akt nënligjor. Ky raport, në fund të vitit 2008 arriti në nivelin 3.1 për qind, nga 2.2 që ishte vitin e kaluar.

Po kështu, sipas nenit 24 të ligjit të mësipërm, pagesa e primit bëhet në katër këste tremujore sipas afateve të përcaktuara në ligj. Njëkohësisht me pagesën e kështit të parë, bankat sjellin pranë Agjencisë deklaratën e primit e cila konfirmon llogaritjen e primit sipas kërkesave të ligjit. Të ardhurat nga primi i sigurimit, të cilat përbëjnë dhe burimin kryesor të të ardhurave të Agjencisë, për vitin 2008 arritën në shumën 1,008,508 mijë lekë, të cilat krahasuar me një vit më parë kanë shënuar një rritje prej rreth 9,7 për qind.

Norma vjetore e primit të sigurimit të depozitave, për vitin 2008 u aplikua e njëjtë për të gjitha bankat, sipas dispozitave të përcaktuara në ligj.

2.3 Kompensimi i depozitës së siguruar

Në ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, janë përcaktuar nivelet për kompensimin e depozitave, me nivel maksimal 700 mijë lekë, e me një aplikim të co-insurance 15 për qind të pjesës mbi 350,000 lekë.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, një nga detyrat kryesore të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është kompensimi i depozitave të siguruara sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se tre muaj nga dita e ndërhyrjes nga Autoriteti Mbikëqyrës në bankën e siguruar. Pra, Agjencia është institucioni përgjegjës për realizimin e funksionit final të saj, kompensimit të depozitave të klientëve në kohë reale dhe në përputhje me dispozitat e përcaktuara në ligj.

Në përmbushje të këtij funksioni, u arrit një nga objektivat tona, miratimi nga Autoriteti Mbikëqyrës i “Rregullores së Kompensimit” dhe “Udhëzimit të Procedurave të Kompensimit”, me urdhër të Guvernatorit nr. 1827 datë 06.03.2008. Ky proces i hap rrugë fillimit të procedurave për përgatitjen e kritereve të hartimit të termave të referencës për informatizimin e procesit të kompensimit.

2.4 Administrimi i mjeteve financiare

Bazuar në ligjin nr. 8873 datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, neni 9, pika 2, neni 21, si dhe në dokumentin e Politikës së Administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë, Agjencia e Sigurimit të Depozitave përgjigjet për administrimin e fondeve me efektivitet dhe në përputhje me standartet e pranuar të menaxhimit të riskut. Administrimi i fondeve realizohet nëpërmjet investimit të mjeteve financiare të Agjencisë në letra me vlerë të qeverisë shqiptare, dhe në letra me vlerë në monedhë të huaj të qeverive, bankave qendrore dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare të vendeve të tjera, monedha e të cilave është në llogari depozitë në bankën e siguruar, me maturim të mbetur jo më shumë se një vit.


Agjencia, për të bërë një menaxhim sa më të mirë të mjeteve të saj financiare dhe për të qenë

në përputhje me kërkesat e ligjit, ka hartuar akte rregullative dhe ka ngritur strukturat e duhura për këtë qëllim .

Struktura e portofolit të investimit sipas maturitetit të mbetur duhet të jetë si më poshtë;

- a) **60 deri në 70 % e Mjeteve Financiare** duhet të investohen në instrumente me maturitet të mbetur jo më shumë se 3 muaj
- b) **30 deri në 40 % e Mjeteve Financiare** duhet të investohen në instrumente me maturitet të mbetur mbi 3 muaj deri në 12 muaj.


Duke mbajtur parasysh konsideratën për maturitetin, shpërndarja e portofolit sipas maturitetit me 31.12.2008 rezulton si më poshtë.



Për sa i përket strukture së portofolit të investimeve sipas monedhave, gjatë vitit 2008 Agjencia ka ruajtur benchmarkun e përcaktuar në politikën e administrimit të mjeteve financiare të saj (të ndryshuar), sipas së cilës:

- Pesha specifike e portofolit të mjeteve financiare në lek duhet të jetë deri në 90% ndaj totalit të portofolit të mjeteve financiare të Agjencisë.
- Pesha specifike e portofolit në monedhë të huaj duhet të jetë deri në 10% ndaj totalit të portofolit të mjeteve financiare të Agjencisë, duke pranuar devijimet nga benchmarku prej $\pm 3\%$.

Duke marrë në konsideratë peshën specifike të nënportofoleve të mjeteve financiare ndaj totalit, shpërndarja e portofolit sipas monedhës më 31.12.2008 rezulton si më poshtë :



3. Gjendja e depozitave të siguruara dhe struktura e tyre

3.1 Ecuria e depozitave të siguruara


Depozitat e klientëve të sistemit bankar shqiptar, në fund të vitit 2008 u rritën me 2.4 për qind krahasuar me fundin e vitit 2007.

Depozitat e individëve, që janë subjekt i skemës së sigurimit të depozitave, zënë një peshë prej 78 për qind kundrejt totalit të depozitave në tërë sistemin bankar, kurse depozitat e siguruara përfaqësojnë rreth 45 për qind të depozitave të individëve.

Pjesën më të madhe të depozitave të individëve e zënë depozitat në lekë dhe vetëm 40 për qind e tyre janë depozita në valutë.

Referuar ecurisë së depozitave të individëve për periudhën njëvjeçare dhjetor 2007 – dhjetor 2008, vërehet një rritje e tyre me 2.1 për qind, kurse depozitat e siguruara shënuan një rënie prej 0.2 për qind, e cila vjen nga ndryshimi i peshës specifike të grupimeve përbërës të strukturës së depozitave, të përcaktuar sipas niveleve të ligjit. Për depozitat e siguruara, vërehet një rritje prej 1.8 për qind e depozitave në valutë dhe një rënie prej 1.1 për qind e depozitave në lekë (si % kundrejt totalit).

Ecuria e depozitave të individëve, gjatë kësaj periudhe njëvjeçare jepet në grafikun e mëposhtëm.




3.2 Struktura e numrit të depozituesve dhe shumës së depozitave sipas niveleve të përcaktuara në ligj

Në fund të dhjetorit 2008, depozitat e agreguara të individëve pas netimit, të shprehura në përqindje sipas niveleve, jepen në tabelën më poshtë:


Struktura e depozitave	Total të agreguara pas netimit	
	Nr.i depozituesve (%)	Shuma (ne %)
Deri 350	76	7
350-700	8	9
mbi 700	16	84
Total	100	100

Depozitat me shumën deri në 700 mijë lekë, zënë rreth 16 për qind të totalit të depozitave të individëve. Kurse numri i depozituesve, të cilët e kanë shumën e depozitave të tyre të agreguara deri në 700 mijë lekë, dominon duke zënë 84 për qind të totalit.

Grafikisht ky informacion paraqitet si më poshtë:




Struktura e shpërndarjes të shumës së depozitave të individëve të agreguar e netuar, sipas niveleve të përcaktuara në ligj (në %)



Krahasimisht, struktura e shpërndarjes së depozitave të siguruara në nivelet e përcaktuara në ligj, sipas numrit dhe shumës, paraqiten në grafikun e mëposhtëm:

Shpërndarja e depozitave të agreguara pas netimit dhe e numrit të depozitorëve, sipas niveleve të ligjit (në %)



4. Gjendja financiare e ASD

Në zbatim të Ligjit nr. 8873 datë 29.03.2002, “Për Sigurimin e Depozitave” neni 28, Agjencia mban llogari dhe rregjistra me qëllim që në çdo kohë të pasqyrohet në mënyrë të saktë gjendja financiare e saj, në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin” si dhe Manualin Kontabël të saj të miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr.250, datë 15.04.2005 “Për miratimin e Manualit Kontabël të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”. Zbatimi i këtij manuali, në mbajtjen e kontabilitetit gjatë vitit 2008 dhe në raportimin e pasqyrave financiare, ka ndikuar

në një pasqyrim bashkëkohor më real e më transparent të gjendjes financiare të ASD- së. Veprimtaria financiare e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave është përjashtuar nga tatimet dhe taksat e drejtpërdrejta.

4.1 Struktura e bilancit dhe ecuria e tij

Në mënyrë të përmbledhur dinamika e Aktiveve dhe Pasiveve të Agjencisë për vitin 2008 paraqitet në pasqyrën e mëposhtme.

Treguesit kryesorë të Bilancit

Përshkrimi (ne mije leke)	31.12.2007	31.12.2008	Ndryshimi
Aktive të qëndrueshme	70.311	67.476	-2.835
Aktive korrente	4.912.925	6.266.951	1.354.026
TOTAL AKTIVE	4.983.236	6.334.427	1.351.191
Kapitali Agjencisë	4.981.826	6.332.595	1.350.769
Pasive të tjera	1.410	1.832	422
TOTAL KAPITALI & PASIVE	4.983.236	6.334.427	1.351.191

4.2 Kapitali dhe ecuria e tij

Kapitali i Agjencisë me datë 31.12.2008 është **6.332.595.059,93** lekë. Ai përbëhet nga fondi themeltar prej 400.000.000 leke, fitimi i akumuluar dhe i pashpërndarë i viteve të kaluara prej **4.581.825.656,72** lekë, si dhe fitimi i vitit ushtrimor prej **1.350.769.403,21** lekë.

PASQYRA E LEVIZJES SE KAPITALIT TE ASD

	31.12.2007	31.12.2008
KAPITALI I AGJENCISE		
<input type="checkbox"/> Kapitali (Fondi Themeltar)	400.000.000,00	400.000.000,00
<input type="checkbox"/> Kapitali (Fondi Themeltar I paguar)		
<input type="checkbox"/> Rezervat		
<input type="checkbox"/> Rezerva rivleresimi		
<input type="checkbox"/> Diferenca rivleresimi		
<input type="checkbox"/> Fitim/humbjet e pashperndara	3.502.689.127,30	4.581.825.656,72
<input type="checkbox"/> Fitim/humbjet e vitit ushtrimor	1.079.136.529,42	1.350.769.403,21
Kapitali gjithsej i Agjencise	4.981.825.656,72	6.332.595.059,93

Kapitali i Agjencisë përbëhet nga elementët e mëposhtëm

Fondi themeltar


Bazuar në Ligjin nr.8873, datë 29.03.2002, “Për Sigurimin e Depozitave”, neni 19, Fondi Themeltar i ASD-se prej 400.000.000 lekë është kontribut i buxhetit të shtetit derdhur nga Ministria e Financave në muajin shkurt të vitit 2003 .

□ **Të ardhura të akumuluar**

Përfaqëson fitimin e akumuluar dhe të pashpërndarë të realizuar nga aktiviteti i Agjencisë gjatë viteve 2002- 2007 i cili rezulton në shumën **4.581.825.656,72** lekë

□ **Të ardhurat e periudhës ushtrimore**

Përfaqëson fitimin e realizuar gjatë periudhës raportuese në shumën **1.350.769.403,21** lekë.



4.3 Fitimi dhe ecuria e tij

Fitimi i ASD-së në vite realizohet nga **Të Ardhurat** që përbëhen nga (a) kontributi fillestar i bankave të siguruara, (b) të ardhurat nga primi i sigurimit që bankat paguajnë pranë ASD-së, (c) të ardhurat nga Operacionet Monetare si dhe (d) të ardhura nga veprimtari të tjera.

□ **Krijimi i të ardhurave**

Të ardhurat e Agjencisë për periudhën raportuese përbëhen nga:


Të ardhura nga kontributi fillestar i bankave të siguruara, të cilat përfaqësojnë pagesat e kontributeve fillestare nga bankat e siguruara në përputhje me Ligjin nr.8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”, neni 23, pika 4 e. Gjatë këtij viti nuk kemi pasur të ardhura nga ky burim sepse nuk është futur në sistem asnjë bankë e re.

Të ardhurat nga primi i sigurimit, të cilat janë të ardhurat më të rëndësishme në portofolin e ASD-së, përfaqësojnë detyrimin ligjor të bankave të siguruara për pagesën e Primit vjetor të sigurimit të depozitave për vitin 2008, në shumën prej **1.008.508.332** lekë, në zbatim të nenit 24, të Ligjit nr.8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”.

Të ardhurat nga Operacionet Monetare, të cilat përfaqësojnë interesat aktive nga investimi i mjeteve financiare të Agjencisë, rezultojnë në shumën **365.501.743,93** lekë (të ardhura të maturuara). Këto të ardhura përbëjnë një tregues të rëndësishëm në fuqizimin e mjeteve financiare të Agjencisë. Të para në vite të ardhurat nga operacionet monetare tregojnë për një qëndrueshmëri në rritje të kthimit nga investimi si dhe për një administrim të mirë dhe me efektivitet të fondeve në përputhje me standartet e pranuar të menaxhimit

të riskut.

Të ardhura nga veprimtari të tjera, të cilat përfaqësojnë të ardhurat nga rivlerësimi i portofolit të letrave me vlerë në monedhë të huaj në shumën **33.640.229,45 lekë**



4.4 Kontrolli i librave dhe llogarive të Agjencisë

Aktiviteti i Agjencisë për vitin 2008, llogaritë dhe regjistrat e saj janë audituar nga auditimi brendshëm. Nga ky auditim rezultoi se këto dokumenta paraqesin me vërtetësi treguesit financiarë të Agjencisë.

1.5 Raporti i Auditit të Brendshëm

Lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2008, auditimi brendshëm ka patur si objektivi:

- vlerësimin e besueshmërisë për informacionin financiar dhe të drejtimit;
- vlerësimin mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm

Në përfundim të auditimit, opinioni për Pasqyrat Financiare të ASD-së është se:

Të dhënat e paraqitura në bilancin kontabël, në pasqyrën e të ardhurave, në pasqyrën *cash flow* dhe në pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, pasqyrojnë në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të ASD-së, performancën financiare dhe fluksin e parave në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.250 datë 15.04.2005, “Për Manualin e Kontabilitetit të ASD”. Ato janë të sakta e të plota në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike për vitin 2008.

Për sa i përket vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, Këshilli Drejtues, Drejtoria e institucionit kanë ndërtuar infrastrukturën apo kuadrin rregullator që kanë ndikuar në menaxhimin me efektivitet të lartë të të gjithë praktikave që përbëjnë zhvillimin e aktivitetit të ASD.

Drejtoria ka ndërtuar aspekte praktike të monitorimit mbi kryerjen normale të detyrave, duke identifikuar mangësitë e brendshme dhe duke vendosur sistemin e kontrolleve financiarë dhe të kontrolleve të tjera në mënyrë të tillë që ofron garanci të mjaftueshme për :

- operacione efektive dhe eficente
- kontrole të brendshëm financiare
- pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat .

Gjatë vitit të kaluar, ASD-ja ka siguruar tregues financiarë që e bëjnë shumë optimiste të ardhmen e misionit të saj. Situatë optimiste ka edhe lidhur me realizimin e treguesve të performancës, të cilat kanë ardhur gjithmonë në rritje dhe në përmirësim të ndjeshëm.

Përfundimisht, auditi i brendshëm shpreh opinionin, se pasqyrat financiare japin vërtetësinë e treguesve financiarë të përgatitur për vitin 2008 nga ASD.

5. Një vështrim mbi veprimtaritë e tjera të ASD gjatë vitit 2008

5.1 Bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë

Agjencia e Sigurimit të Depozitave si një nga hallkat kryesore që ndihmon në ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit bankar, vazhdon të bashkëpunojë ngushtë me Autoritetin Mbikëqyrës (Bankën e Shqipërisë), nëpërmjet shkëmbimit reciprok të informacionit, duke konkretizuar në këtë mënyrë marrëveshjen e nënshkruar midis Bankës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, si dhe duke respektuar ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”.

Bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë është fokusuar në mënyrë të veçantë, në diskutimin dhe finalizimin e disa projekteve të ASD-së për plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e sigurimit të depozitave. Për këtë qëllim, nëpërmjet grupeve të përbashkëta të punës, të përbërë nga ekspertë të ASD-së dhe Bankës së Shqipërisë është bashkëpunuar për:

- 1.1.1 *Plotësimin e kuadrit ligjor që mundëson dhe garanton ngritjen dhe mirëfunksionimin e një mekanizmi të koordinuar për realizimin e procesit të kompensimit të depozitave të siguruara nga ASD.*

Gjatë vitit 2008, me Urdhërin e Guverantorit të Bankës së Shqipërisë nr. 1827, datë 06.03.2008, u miratuan dy dokumente shumë të rëndësishme për procesin e kompensimit, konkretisht: Rregullorja “Për Kompensimin e Depozitave” dhe Udhëzimi “Për procedurat e kompensimit të depozitave të siguruara”.

Rregullorja “Për kompensimin e depozitave” është dokumenti që rregullon afatet dhe përcakton mënyrat e kompensimit, ndërsa Udhëzimi “Për procedurat e kompensimit të depozitave të siguruara”, paraqet në mënyrë të detajuar procedurat e kompensimit të depozitave. Këto dy materiale të rëndësishme, plotësojnë kuadrin ligjor që mundëson dhe garanton ngritjen dhe mirëfunksionimin e një mekanizmi të koordinuar për realizimin e procesit të kompensimit të depozitave të siguruara.

- 1.1.2 *Mbi disa ndryshime ne ligjin nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për sigurimin e depozitave”.*

Në zbatim të rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë, miratuar me Rezolutën e datës 26.05.2008 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2007”, ASD, gjatë vitit 2008 përfundoi fazën studimore të projektit të saj për rishikimin e ligjit për sigurimin e depozitave, gjatë së cilës u identifikuan drejtimit kryesore të nevojshme për ndryshimet në ligj mbi bazën e zhvillimeve të legjislacionit europian, përvojës së institucioneve homologe të përparuara në fushën e sigurimit të depozitave, si dhe analizës së impaktit që do të sillnin këto ndryshime në gjendjen financiare të ASD.

1.1.3 Formalizimin e bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave nëpërmjet marrëveshjeve të huasë për sigurimin e likuiditeteve të nevojshme për kryerjen e procesit të kompensimit të depozituesve .

Një projekt me rëndësi prioritare për punën e ASD-së është formalizimi i mekanizmave për sigurimin e likuiditeteve të nevojshëm për realizimin e procesit të kompensimit.

Për këtë qëllim, ASD në vitin 2008 me mbështetjen e ekspertizës teknike të ofruar nga Zyra e FSVC në Tiranë përfundoi studimin për identifikimin e mënyrave më efëiente për sigurimin në kohë të likuiditeteve të nevojshme, duke marrë si bazë edhe përvojat e institucioneve homologe në këtë drejtim.

5.2 Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare dhe homologët

Agjencia gjatë vitit 2008 ka zhvilluar marrëdhëniet e saj me institucionet dhe organizmat ndërkombëtare në fushën e sigurimit të depozitave, duke kontribuar kështu në përmirësimin e dialogut midis autoriteteve dhe anëtarëve të skemës së sigurimit.

Agjencia si një institucion anëtar i organizatës “Shoqata Ndërkombëtare e Siguruesve të Depozitave” (IADI), merr pjesë në mënyrë aktive në komitetet e përherëshme të kësaj organizate dhe në grupet e përherëshme të punës. Aktualisht, Drejtori i Përgjithshëm i ASD-së është anëtar i Këshillit Ekzekutiv të kësaj organizate.

Agjencia, duke qenë një nga institucionet themeluese të Forumit Europian të Siguruesve të Depozitave, i cili është rregjistruar si një shoqëri jo fitimprurëse sipas ligjit të Komunitetit Europian me seli në Bruksel, merr pjesë në mënyrë aktive në shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave shumëpalëshe, lidhur me çështje ndërkufitare si dhe iniciativat për rishikimin e legjislacionit europian të skemave të sigurimit të depozitave.

Pjesëmarrja e Agjencisë në organizatat ndërkombëtare të sigurimit të depozitave, i shërben harmonizimit të legjislacionit të saj në përputhje me Direktivën 94/19 të Komunitetit Europian “Për skemat e sigurimit të depozitave” dhe ndryshimeve të saj, duke i paraprirë përshtatjes së kuadrit legjislativ të sigurimit të depozitave në Shqipëri, me kërkesat e “acquis communautaire”.

5.3 Edukimi dhe informimi i publikut

Edukimi dhe informimi i publikut është thelbësor në funksionimin në mënyrë efektive

të sistemit të sigurimit të depozitave. Edhe gjatë vitit 2008, në zbatim të rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë, miratuar me Rezolutën e datës 26.05.2008 “Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2007”, Agjencia ka punuar në vazhdimësi për të bërë të njohur tek depozituesit skemën e sigurimit të depozitave dhe rolin e saj në procesin e kompensimit në rast të ndonjë falimentimi të ndonjë banke.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave vazhdon të informojë depozituesit nëpërmjet mjeteve të njohura të komunikimit. Ruajtja e kontaktit të vazhdueshëm me publikun në përgjithësi dhe depozituesit e bankave të nivelit të dytë në Shqipëri, si nëpërmjet shpërndarjes së materialeve informuese, broshura shpjeguese, fletëpalosjet informuese, ashtu dhe me prezencën e detyrueshme të logos së ASD-së në të gjitha bankat.

Agjencia, me qëllim rritjen e efektivitetit të programit të edukimit dhe informimit të publikut hartoi dokumentin “*Politikat e edukimit dhe informimit të publikut*”, i cili u miratua me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 215, datë 05.06.2008. Në këtë dokument, Agjencia ka evidentuar bankat anëtare të skemës sonë, si një nga grupet e interesit drejtpërsëdrejti të lidhura me të dhe me depozituesit e vegjël.

Në zbatim të këtij dokumenti të rëndësishëm, gjatë vitit 2008, Agjencia në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave, ndërmori një fushatë sensibilizuese, duke organizuar në Tiranë dhe në disa nga qytetet kryesore të vendit një cikël seminaresh me temë “Çështje të sigurimit të depozitave në Shqipëri”.

Këto seminare u organizuan në formën e forumeve të hapura, ku punonjësit e Agjencisë prezantuan çështje të sigurimit të depozitave, mbi të cilat u zhvilluan diskutime me përfaqësuesit e bankave të nivelit të dytë që operojnë në qytete të ndryshme të vendit.

Qëllimi kryesor i kësaj iniciative të Agjencisë, ishte prezantimi i zhvillimeve më të fundit në fushën e sigurimit të depozitave dhe shkëmbimi i informacionit dhe forcimi i dialogut ndërmjet palëve pjesëmarrëse në skemën e sigurimit të depozitave, në funksion të rritjes së performancës profesionale në zbatim të ligjit nr. 8873, datë 29.03.2002 “Për Sigurimin e Depozitave”. Ndër çështjet që u trajtuan me prioritet në këtë cikël seminaresh ishte informimi i depozituesëve për të drejtat që ata gëzojnë në bazë të ligjit “Për sigurimin e depozitave”, si dhe menaxhimi i komunikimit me depozituesit në situatën e një krize financiare.

6. Drejtimet kryesore të planit të zhvillimit për vitin 2009

- 1.1 Gjatë vitit 2009, Agjencia do të fokusojë planin e saj të zhvillimit në drejtim të:
 - a. rishikimit dhe përmirësimit të politikave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave në varësi të ndryshimeve të mundshme të kuadrit ligjor në fushën e sigurimit të depozitave.
 - b. bashkëpunimit me institucione të specializuara për asistencë teknike me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës për realizimin e procesit të kompensimit.

AGJENCIA E SIGURIMIT TE DEPOZITAVE

BILANCI PERMBLEDHES
Per periudhen 01.01.2008 deri 31.12.2008

Ne leke

	AKTIVET	N 31.12.2008	N-1 31.12.2007
A	Mjete Monetare dhe ekuivalentet e tyre	208.842.616,31	19.625.637,78
	1- Mjete monetare prane Bankes se Shqiperise	71.464,46	15.702.615,12
	2-Ekuivalente te mjeteve monetare	205.500.000,00	0,00
	3- Llogari administrative prane bankave	3.268.608,85	3.923.022,66
	* ne leke (Raiffeisen Bank)	1.879.151,92	492.659,04
	* ne leke (BKT Tirana 3)	455,24	454,78
	* ne leke (CREDINS)	121.054,85	
	* ne valuta (RaiffeisenBank)	516.423,01	1.695.660,06
	* ne valuta (BKT Tirana 3)	323.728,12	310.799,40
	* ne valuta (State Treet Bank)	427.795,71	1.423.449,38
	4- Arka	2.543,00	0,00
B	Investime ne Letra me Vlere te Qeverise	5.787.902.496,64	4.646.858.825,43
	1- Investime ne LVL te Qeverise Shqiptare	4.850.947.756,00	3.943.116.500,00
	2- Investime ne LVL te Qeverive te Huaja	1.036.148.230,00	830.647.697,43
	3- Interes i Arketueshem (Bono Thesari)	-102.654.260,00	-126.905.372,00
	4- Skonto, cmimi, primi LVL	3.460.770,64	0,00
C	Llogari te Arketueshme	270.205.504,81	246.439.862,61
	1- Prime te arketueshme	251.156.305,77	229.616.719,00
	2- Interes i perllogaritur si e ardhur (LVL)	18.969.463,04	16.743.407,61
	3- Kerkesa per arketim ndaj Bankave te falimentuara	0,00	0,00
	4- (-) Zhvleresimi i kerkesave per arketim	0,00	0,00
	5- Te tjera te arketueshme (debitore)	79.736,00	79.736,00
D	Aktive te tjera	67.475.997,17	70.311.469,90
	1-Aktive te Qendrueshme	66.485.853,70	69.100.871,60
	a- Aktive te Qendrueshme te Patrupezuara	1.083.600,00	1.083.600,00
	b- Aktive te Qendrueshme te Trupezuara	91.488.792,30	89.644.037,30
	(-) Zhvleresim i Akumuluar i AQ	-26.086.538,60	-21.626.765,70
	2- Materiale	793.894,47	1.078.957,30
	3- Shpenzime per tu shperndare	196.249,00	131.641,00
	T O T A L I (A+B+C+D)	6.334.426.614,93	4.983.235.795,72
	Llogari Jashte Bilancit		
	Kerkesa per arketim		
	Te tjera llogari angazhimesh		
	AKTIVET GJITHSEJT	6.334.426.614,93	4.983.235.795,72

			Ne leke
	DETYRIMET DHE KAPITALI (PASIVET)	N-1 31.12.2008	N 31.12.2007
A	DETYRIME	1.831.555,00	1.410.139,00
	I. Detyrime Afatshkurtra	1.831.555,00	1.410.139,00
	1. Kompensimi I depozitave te siguruara	0,00	0,00
	2. Kred/ Hua Afatshkurtra	0,00	0,00
	3. Kreditore te tjere	1.831.555,00	1.410.139,00
	* Shpenzime te llogaritura	129.857,00	165.000,00
	* Kreditor per kontrata	1.002.574,00	646.136,00
	* Detyrime per Sigurime shoqerore/shendetesore	337.367,00	272.182,00
	* Detyrime per Tatim mbi te ardhurat	361.757,00	326.821,00
	II. Detyrime Afatgjata	0,00	0,00
	1. Kredi/Hua Afatgjata		
	2. Kreditore te tjere		
	III. Provigjone	0,00	0,00
	1. Provigjone te pergjitheshme		
	2. Provigjone per humbje nga falimentimi		
	3. Provigjone te tjera		
B	TE ARDHURA TE MARA NE AVANCE	0,00	0,00
C	SUBVENCIONE DHE DONACIONE	0,00	0,00
D	FONDE	6.332.595.059,93	4.981.825.656,72
	I. Fondi themeltar (kapitali I themelimit)	400.000.000,00	400.000.000,00
	II. Rezervat		
	III. Fondi I Akumuluar	4.581.825.656,72	3.502.689.127,30
	IV. Fitimi dhe Humbja (-) e vitit Ushtrimor	1.350.769.403,21	1.079.136.529,42
	T O T A L I (A+B+C+D)	6.334.426.614,93	4.983.235.795,72
	Llogari Jashte Bilancit		
	Te ardhura ne pritje per arketim		
	Te tjera llogari angazhimesh		
	PASIVET GJITHSEJT	6.334.426.614,93	4.983.235.795,72

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
Per periudhen 01.01.2008 deri 31.12.2008

N R	PASQYRA E TE ARDHURAVE (ne leke)	N	N-1
		31.12.2008	31.12.2007
	TE ARDHURAT	1.407.669.955,27	1.185.611.480,28
	Nga keto:		
A	Nga veprimtaria e sigurimeve	1.008.527.981,89	919.121.000,80
	1. Te ardhura nga Kontributi fillestar	0,00	0,00
	2. Te ardhura nga primet	1.008.508.332,00	919.105.972,66
	3. Te ardhura te tjera qe lidhen me to	19.649,89	
	* per veprimet me thesarin dhe nderbankare (komisione ne leke)	19.649,89	15.028,14
	* per veprimet me thesarin dhe nderbankare (komisione ne valute)	0,00	0,00
	* per veprimet me klientet	0,00	0,00
B	Nga veprimtaria operative	365.501.743,93	266.490.479,48
	1. Te ardhura nga interesi I depozitave	9.637.812,55	542.244,97
	2. Te ardhura nga interesi I Letrave me Vlere	355.863.931,38	265.948.234,51
	a- te Qeverise Shqiptare	318.012.821,00	230.311.107,00
	b. te Qeverive te Huaja	35.852.088,60	32.317.966,21
	c. te ardhura te tjera qe lidhen me to(skonto)	1.999.021,78	3.319.161,30
	3. Diferenca konvertimi	0,00	0,00
C	Rimarje provigjonesh	0,00	0,00
D	Te ardhura nga falimentimi	0,00	0,00
E	Te ardhura te tjera(rivleresin LVL + te tjera)	33.640.229,45	0,00
1	TOTALI A+ B+ C+ D+ E	1.407.669.955,27	1.185.611.480,28
	SHPENZIMET	56.900.552,06	106.474.950,86
	Nga keto:		
A	Shpenzime Operative	26.667.546,06	23.127.169,95
	1. Shpenzime materiale dhe te ngjashme	13.379.890,37	10.919.159,46
	2. Shpenzime financiare	8.827.882,79	7.524.070,99
	a. interesa per Kredi/Huate (kom)	0,00	0,00
	b. komisione bankare(leke+valute)	1.583.923,45	1.579.556,28
	c. te tjera (te paparashikuara)	0,00	0,00
	d. shpenzime per zhvleresim te LVL	7.243.959,34	5.944.514,71
	3. Amortizimi I Aktiveve te Qendrushme	4.459.772,90	4.683.939,50
	4. Kuota e shpenzimeve per t'u shperndare	0,00	0,00
B	Shpenzime Personeli	26.757.432,00	23.916.074,00
	1. Paga + shperblime	22.983.095,00	20.886.783,00
	2. Sigurime shoqerore	2.320.102,00	2.262.126,00
	3. Te tjera te ngjashme	1.454.235,00	767.165,00
C	Tatime Taksa e te ngjashme	0,00	0,00
D	Provigjone	0,00	0,00
E	Te tjera operative	3.475.574,00	3.246.572,00
	Shpenzime Bordi	3.475.574,00	3.246.572,00
F	Shpenzime Falimentimi	0,00	0,00
G	Shpenzime te periudhave te kaluara	0,00	0,00
H	Shpenzime te paparashikuara	0,00	784.220,00
K	Te tjera	0,00	0,00
	TOTALI A+ B + D + E + F + G + H + K	56.900.552,06	51.074.035,95
E1	Te tjera operative (diferenca konvertimi)	0,00	55.400.914,91
	Diferenca rivleresimi te LVL ne EURO	0,00	29.243.134,91
	Diferenca rivleresimi te LVL ne USD	0,00	26.157.780,00
2	TOTALI A+ B + D + E + F + G + H + K+E1	56.900.552,06	106.474.950,86
	REZULTATI	1.350.769.403,21	1.079.136.529,42

AGJENCIA SIGURIMIT TE DEPOZITAVE

PASQYRA E RRJEDHJES SE PARASE

(Per daten 31.12.2008)

(ne Leke)

	PASQYRA E RRJEDHJES SE PARASE	31.12.2008 N	31.12.2007 N-1
1	AKTIVITETE OPERATIVE		
	* Prime te arketuara	1.008.508.332,00	919.105.972,66
	* Kerkesa te arketuara	-	-
	* Hua te mara		
	* Te ardhura nga interesi	365.501.743,93	265.948.234,51
	* Rikuperim i shumave me pare te zhvleresuara	-	-
	* Te tjera shuma te arketuara	2.369.663,43	557.273,11
	* Pagesa per punonjesit	- 30.233.006,00	- 24.001.531,00
	* Pagesa ndaj Furnitoreve	- 3.870.148,32	- 2.916.617,00
	* Te tjera pagesa	- 10.599.851,13	- 13.484.164,16
	Fluksi I parave nga Aktivitetet Operative	1.331.676.733,91	1.145.209.168,12
2	AKTIVITETE INVESTUESE		
	* Blerje e Aktiveve te Qendrushme (materiale)	- 1.559.692,17	- 1.442.899,30
	* Blerje e letrave me Vlere	- 1.113.331.788,57	- 1.277.427.933,33
	* (Interes i arketueshem)	- 24.251.112,00	- 16.743.407,61
	* Depozita afatgjate	- 3.317.162,64	0
	* Shitje e Letrave me Vlere	-	-
	* Arketime nga shitja e AQT	-	-
	Fluksi I Parave nga Aktivitete Investuese	- 1.142.459.755,38	- 1.295.614.240,24
	Rritja (Pakesimi) neto i parase gjate Vitit (1 +2)	189.216.978,53	- 150.405.072,12
	Gjendja e parase ne fillim te vitit	19.625.637,78	170.030.709,90
	Gjendja e parase ne fund te vitit	208.842.616,31	19.625.637,78